



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË
ZYRA VENDORE E ARSIMIMIT PARAUNIVERSITAR VORË

Nr 522/Prot

Vorë 25 . 08 .2026

NJOFTIM PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE NË INSTITUCIONET ARSIMORE TE ZVAP VORË:

Në mbështetje të ligjit Nr.69/2012 datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në urdhërin nr 31 datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr 10171 datë 22.10.2009 "Për profesionin në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, në urdhërin nr. 100 datë 25.02.2022 e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, kreu VI "Vlerësimi i praktikantit" neni 20 "Komisioni i vlerësimit të praktikantëve, në urdhërin nr 437 prot, datë 20.07.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit" në shkresën e AKAP nr 2298/1. Prot, datë 21.08.2026 "Kërkesë për hapjen e shërbimit online". Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit janë të gjithë ata kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57 të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Për vitin shkollor 2026-2027, aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit do të kryhet nëpërmjet platformës e-albania . Afati për aplikimin e zhvillimit të praktikës profesionale për periudhën e parë, është nga data 26.08.2026-04.09.2026 në ZVAP VORË.

Dokumentacioni që kerkohet:

- 1.Kërkesë për zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit sipas shtojcës 5-të të Urdhërit Nr .100 datë 25.0.2022 (dërgohet automatikisht nga sistemi e-albania sapo aplikanti të plotësojë të dhënat në sistem)
2. CV e praktikantit;
3. Skanim nga origjinali i dokumentit të identifikimit;
4. Skanim nga origjinali e diplomave Bachelor dhe Master me lista notash;
- 5.Raport mjeko-ligjor
- 6.Vërtetim nga prokuroria
- 7.Vërtetim nga gjykata.
- 8.Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.

Mungesa e një dokumentacioni të sipërcituar, çon në skualifikimin e dosjes.

DREJTOR

MIMOZA LALA



Adresa: Rruga "Mema"

Email: ZVAvore@arsimi.gov.al